

QEVERISJA E MIRË
QEVERISJE E HAPUR DHE
LLOGARIDHËNJE NË
POLITIKË DHE PUSHTET

Autore: Blerina Ramaj, Open Data Kosovo

Analizë mbi hapjen institucionale të Organeve të drejtësisë

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

Shtator 2019



Ky publikim është prodhuar nga asistenca e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit ACTION SEE – Llogaridhënja, Teknologjia dhe Hapja institucionale në rajonin e Evropës Juglindore.

Autore: Blerina Ramaj, Open Data Kosovo

**Analizë mbi hapjen
institucionale të Organeve të
drejtësisë**

Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale

Prishtinë, Shtator 2019

Hyrje

Në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal "ActionSEE SHC", Open Data Kosovo, kemi përgatitur një dokument ku analizojmë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies të sistemit gjyqësor në Kosovë, me synim rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjatë matjes së mëparshme për vitin 2017, organet e gjyqësore nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë korrur rezultate të kënaqshme në lidhje me qeverisjen e hapur. Shumica e indikatorëve bazë të performancës nuk plotësohen nga gjykatat rajonale e që këto të fundit kanë arritur rezultat (37%) dhe prokuroritë publike (24%).

Për matjen e sivjetme, anëtarët e rrjetit ActionSEE kanë vazhduar të përmirësojnë metodologjinë e hulumtimit të vitit të kaluar dhe indikatorëve të vet duke mundur krahasim direkt ndërmjet shteteve dhe organeve të drejtësisë. Qeverisja e hapur në organet e gjyqësorit në rajonin e Ballkanit Perëndimor në matjen e sivjetme arrin në 35% të indikatorëve krahasuar me performancën e vitit të kaluar ku ajo arrinte plotësimin e 36% të indikatorëve të performancës. Ky rezultat që tregon një rënie të performancës së organeve gjyqësore është një kampion alarmi për transparencën dhe përgjegjshmërinë e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve.

Sfidat e reformës së vazhdueshme në të gjithë rajonin për këto organe, si dhe rezultati i ulët i transparencës, nuk jep përshtypjen se angazhime konkrete po ndërmerren për nxitjen e transparencës, fuqizimin e qytetarëve dhe veprimet anti-korrupsion. Qeverisja e hapur nuk është vetëm qëllim për pushtetet ekzekutive dhe legjislative, por është gjithashtu një nevojë për gjyqësorin, për të kuptuar se çfarë mund të bëjmë për tu përmirësuar qeverisja, shoqëria dhe demokracia.

Ne besojmë se të tilla qasje të shtrënguara për hulumtim i janë shtuar faktit se rezultatet tregojnë një rënie në hapjen e organeve të drejtësisë. Nga ana tjetër, rezultatet dhe të dhënat e analizuara tregojnë se gjyqësori nuk ka bërë asnjë përpjekje për të zhvilluar qeverisje të hapur që nga publikimi i rezultateve të mëparshme, pra indikatorët e rinj nuk janë të një rëndësie vendimtare për një rënie të përgjithshme të qeverisjes së hapur. Duhet të ndërmerren hapa urgjent dhe konkret për të përmirësuar performancën e këtij pushteti për të rikthyer besimin e publikut në organet e drejtësisë.

Analiza jonë i drejtohet vendimmarrësve në gjykata dhe prokurori në vendet e rajonit. Mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe kolegët tanë nga OJQ-të, që merren me këto çështje. Ne mbetemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikrat dashamirëse dhe diskutimet lidhur me dokumentin e politikës sonë.

Gjykatat dhe Prokuroritë në Rajon

Gjykatat në rajon

Rezultatet e hulumtimeve të kryera tregojnë një rënie në performancën e gjykatave në përmbushjen efektive të indikatorëve për qeverisje të hapur. Gjykatat në rajon duket të kenë një rezultat të ulët, kur bëhet fjalë për qasshmëri në informata dhe në parandalimin e konfliktit të interesit. Rreth gjysma e gjykatave në rajon nuk i është përgjigjur pyetësorit të dërguar atyre, gjë që vërteton rezultat të ulët të qasshmërisë ndaj informacionit. Edhe pse me ligj është e përcaktuar që gjykatat të kenë një person të caktuar që merret me DQT, informacionet e personit kontaktues ende nuk janë në dispozicion në faqet zyrtare në internet.

Nga ana tjetër shkalla deri në të cilën gjykatat rajonale janë të hapura ndaj qytetarëve, sipas katër parimeve bazë, është si vijon: transparencja 41%, ndërgjegjësimi 39%, qasshmëria 34% dhe integriteti me 34% të indikatorëve të plotësuar. Përveç parimit të transparencës, që arrin rezultat prej 1%, më të lartë, të tjerat kanë shënuar rezultat negativ në krahasim me matjen në vitin 2017. Situata paraqitet më mirë kur është fjala për këshillat e gjykatave rajonale, ku parimet Indeksit të Qeverisjes së Hapur Rajonale dolën më mirë se rezultatet paraprake.

Parimi i ndarjes së rastësishme të lëndëve

Ndarja e rastësishme e lëndëve në gjykata është në nivel rajonal. Krahasuar me vitin e mëparshëm, ky rezultat i indikatorëve vazhdon të mbetet për afërsisht i njëjtë, kështu që nuk ka asnjë rritje në të gjitha instancat e gjykatave. Pasi që ndarja e rastësishme e lëndëve është thelbësore për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, hapa konkret të veprimit dhe ndërhyrje janë të rëndësishme në zhvillimin dhe përmirësimin e këtij parimi. Mos rritja e performancës nga rezultati i vitit të mëparshëm, do të thotë që nuk janë bërë përpjekje në kompletimin e kornizës ligjore për parandalimin e zhvillimit të korrupsionit në gjyqësor, por, megjithatë, ka ende shumë punë për të bërë për shkak të rënies së besimit të publikut në vazhdimësi në këtë sistem.

Publiciteti i gjykimeve

Procedurat gjyqësore janë të hapura për publikun, me përjashtime të kufizuara kur është fjala për shembuj me rastet e të miturve. Është shënuar rezultat i kënaqshëm kur vjen puna e respektimit të kushteve bazë të paanësisë së gjykimeve. Ky është një rezultat i ulët krahasuar me matjen e vitit të kaluar ku rezultati ishte 92%. Edhe në matjet e sivjetme, është vërejtur shkelje e këtij parimi, për shkak të rezultateve të qasjes në sallat e gjyqit të personave me aftësi të kufizuara. Shumica e gjykatave në rajon dështojnë në ofrimin e mundësive për qytetarët që të kenë akses në zyrat e tyre, edhe pse ka akte ligjore sipas të cilave është një detyrim për të gjitha institucionet publike për përshtatjen e infrastrukturës së objekteve të tyre për të lehtësuar aksesin e këtij grupi të marginalizuar.

Publikimi i informacionit dhe vendimet

Qasja në informacione publike të gjykatave në Ballkanin Perëndimor nuk arrin më shumë se 43% të treguesve të plotësuar, megjithatë, kjo shënon rritje në përmbushjen e treguesve në krahasim me vitin e kaluar ku rezultati i matjes ishte 30%. Një numër i madh i gjykatave në rajon nuk kanë faqet e tyre, si dhe publikojnë vetëm një numër të vogël të aktgjykimeve në internet. Për më tepër, në disa faqe të gjykatave, nuk funksionon opsioni i makinës kërkimore. Për shkak të kësaj, qytetarët përballen me vështirësi në gjetjen e informacionit publik ose përparimin në qasje të rasteve të tyre. Vendimet gjyqësore të publikuara së bashku me arsyetimet mbeten shqetësim lidhur me procesin e matjeve. Shumica e vendimeve nuk janë publikuar në tërësi apo fare në rajonet e opinioneve nga gjyqtarët si pjese e paneleve të procedurave, e cila rrit nivelin e perceptimit rreth korrupsionit apo konfliktit të interesit në këto institucione.

Prokuroria Publike në rajon

Prokuroria si term i përgjithshëm përfshin Këshillin Prokurorial, Prokurorinë publike dhe prokurorinë e shtetit. Rezultatet për matjen e hulumtimeve të sivjetme janë afërsisht të njëjta kur bie fjala për performancën e prokurorisë në rajon në krahasim me rezultatet e vitit të kaluar. Në vitin 2017 prokuroria arriti të shënojë 23% të plotësimit të indikatorëve për qeverisje të hapur, ndërsa në vitin 2018 janë shënuar 24%.

Një nga arsyt kryesore për këtë rezultat të ulët në perspektivë rajonale vjen nga shtetet e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë, që kanë arritur të plotësojnë më pak se 20% të indikatorëve. Kjo arritje e ulët, vjen si rezultat që institucionet e shënjestruara nuk kanë në dispozicion faqe interneti apo kontakte për t'ia dërguar këtë pyetësor. Megjithatë në shtetet e tjera, ka shumë punë për tu bërë sidomos për parandalimin e konfliktit të interesit dhe raportimin e punës, si dhe për transparencën e këtyre institucioneve. Shkallët e zyrave rajonale të prokurorisë të cilat janë të hapura për qytetarët, sipas katër parimeve bazë janë si më poshtë: qasshmëria me 28%, ndërgjegjësimi me 37%, integriteti me 34% dhe transparenca me 24% të indikatorëve të plotësuar. Transparenca, qasshmëria dhe integriteti kanë pësuar një rënie të lehtë në krahasim me vitin e kaluar kur është kryer matja.

Transparenca dhe qasshmëria në informacion lidhur me punën

Zyrat e Prokurorisë Publike në rajon kanë shënuar rezultat të ulët lidhur me transparencën e informacionit organizativ në shërbim të qytetarëve, me një rezultat prej 19% të indikatorëve të plotësuar. Ky rezultat i ulët ka reflektuar edhe me të drejtën për qasje në informacion në nivel rajonal, si dhe me shumë pak informacion që është në dispozicion online.

Rezultati i vitit të kaluar ishte 23%, por matjet e këtij viti tregojnë një rritje të lehtë nga 23% në 25%, megjithatë prokuroritë publike në rajon, në përgjithësi, nuk janë duke ofruar mundësi për palët e interesuara për të pasur akses në informacion që duhet të jetë i hapur për publikun dhe se këto zyra kanë dështuar në krijimin e një sistemi online më transparent, ku të gjitha të dhënat duhet të jenë

të dukshme. Shumica e zyrave të prokurorisë publike nuk ofrojnë asnjë lloj të mekanizmit për komunikim të drejtpërdrejtë me prokurorët. Për më tepër, prokuroritë në rajon në faqet e tyre nuk ofrojnë informata adekuate në faqen e tyre të internetit ose një kënd për të ngritur shqetësime. Sistemi i drejtësisë si i tërë nuk ka arritur të krijojë një sistem elektronik i cili do të ndjekë online aktakuzat dhe ecurinë e tyre në procedim e sipër, edhe pse disa vende që kanë krijuar këtë sistem online ende nuk arrijnë ta kenë funksional. Këto çështje janë paraqitur që nga viti i kaluar, dhe përmirësimi nuk është shumë i madh.

Marrëdhëniet me medie dhe publikun

Një nga komponentët më të rëndësishëm është edhe marrëdhënia me medie dhe publikun. Shumica e prokurorive publike duhet të miratojnë rregulloret për komunikim me media dhe sesi ato prezantojnë punën e tyre me publikun. Këto rregullore në përputhje me udhëzimet për stafin i cili ka për detyrë të bashkëpunojë me mediat do ta lehtësonin rrugën për të komunikuar dhe do ta rrisnin bashkëpunimin me medie dhe publikun. Për më tepër, të tillë udhëzues janë më se të nevojshëm për të shmangur rrezikimin e rrjedhës së informacionit gjatë procedurës apo hetimit. Problemet më të zakonshme, si shkelje të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të raportimit në procedurat penale, janë si në vijim: njëanshmëria e raportimi të mediave, shkelja e fshehtësisë dhe prezymimi i pafajësisë, rrjedhja e 'informacionit' nga zyra e prokurorisë dhe policisë, shpalosja e informacionit sekret në fazën e hetimeve.

Kontrolli i punës së Prokurorive Publike

Si vitin e kaluar, dy të tretat e vendeve të rajonit kanë krijuar një mekanizëm për kontrollin dhe monitorimin e punës së Prokurorive Publike nga shkalla më e lartë. Për më tepër, një tjetër mekanizëm i rëndësishëm i miratuar nga zyra të prokurorisë publike është ai për ndarjet e lëndëve, gjë që më shumë se 80% e prokurorive publike kanë miratuar dhe është një domosdoshmëri që prokuroritë e mbetura ta miratojnë atë. Megjithatë, funksionimi i këtyre dy mekanizmave në praktikë është ende i diskutueshëm. Shumica e prokurorive publike nuk kanë publikuar ose nuk kanë bërë publike raportet e masave disiplinore, ankesat ndaj prokurorëve apo raportet e vitit të kaluar tek autoriteti mbikëqyrës. Mos dokumentimi dhe publikimi i tyre në internet

e bën të pamundur për palët e interesuara që të mësojnë nëse mekanizmat janë duke funksionuar dhe në fakt nëse kanë ndikim.

Gjyqësori në Kosovë

Sistemi i drejtësisë në Kosovë është kritikuar në mënyrë sistematike për paaftësi, anësi politike dhe kapacitete të pamjaftueshme në të gjitha nivelet, për të përmendur vetëm disa shkaqe për shqetësimet e ngritura nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë. Sipas vëzhguesve, progres është arritur pasi që Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Ligji për Ndërmjetësim janë miratuar. Përveç kësaj, për avancimin qeverisjes së hapur në organet e gjyqësorit është edhe futja e sistemit të menaxhimit elektronik dhe publikimi i aktgjykimeve online nga gjykatat. Në këtë drejtim, dokumenti do të analizojë hapjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Gjykatave, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorive publike dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit lidhur me nivelet e tyre të qasshmërisë, ndërgjegjësimit, integritetit dhe transparencës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Gjykatat

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka arritur 50% dhe u rendit i treti pas Malit të Zi (79%) dhe Bosnja dhe Hercegovina me (63%) të përmbushjes së indikatorëve. Ky është një avancim për nivelin e transparencës, ndërsa në matjen e fundit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u rendit si i parafundit në rajon. Të gjitha vendet në rajon kanë shënuar përparim në rritjen e nivelit të transparencës së këshillave gjyqësore, me përjashtim të Serbisë, ndërsa nga viti i kaluar ka zbritur në nivel prej 10% të indikatorëve të plotësuar.

Në anën tjetër gjykatat arritën rezultat prej 47% një rritje prej 4% në plotësimin e indikatorëve por ku matjet nga vitet e fundit ende e rendisin si të tretin. Prin Mali i Zi dhe Shqipëria me 56% gjegjësisht me 49% të indikatorëve të plotësuar. Kosova lë pas Maqedoninë me 43 për qind të indikatorëve të plotësuar, Serbinë me 26% dhe në fund në radhë është Bosnje dhe Hercegovina me 25% të indikatorëve të rezultatit.

Sistemi i ri i ueb faqeve është prezantuar në gjykatat e Kosovës, ato kanë arritur të rrisin praninë e tyre në internet dhe shkëmbimin e informatave me publikun.

Në mënyrë që të jetë në gjendje të krijoj ndërhyrjet përshtatshme me synim rritjen e qasshmërisë, ndërgjegjësimit, integritetit dhe transparencës. Institucionet e përfshira në vlerësim janë Gjykata Themelore e Ferizajt, Gjykata Themelore e Gjilanit, Gjykata Themelore e Mitrovicës, Gjykata Themelore e Pejës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Qasshmëria

Kur është fjala për qasshmërinë, Këshilli Gjyqësor ka arritur plotësimin e 17% të indikatorëve dhe Gjykatat kanë arritur 44%, pra Këshilli renditet i fundit në rajon, ndërsa gjykatat janë renditur të tretat në rajon. Gjykata Themelore e Gjilanit me një rezultat prej 59% pasuar nga Gjykata Supreme me një rezultat prej 55% janë ilustrues të mirë lidhur qasjen. Përkundrazi, qasshmëria më e ulët është te Gjykata Themelore e Mitrovicës me 25% rezultatin dhe Këshilli Gjyqësor, e cila arriti 17%. Është bërë përparim lidhur me themelimin e një zyre për çështje publike dhe botimin e kontakteve të personit përgjegjës për qasje në informata me rëndësi publike në faqen e internetit. Megjithatë, bazuar në përgjigjet e pranuar, të gjithë zyrtarët publik përgjegjës për komunikim, vunë në dukje se vetëm një person përgjegjës për komunikim nuk është i mjaftueshëm, pasi që është përgjegjës për të gjitha detyrat e tjera, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kumtesat për shtyp, menaxhimi i faqes zyrtare dhe faqes së Facebook-ut, publikimi i aktgjykimeve, ruajtja e postave elektronike zyrtare të gjykatës, etj.

Për më tepër, ka një sistem elektronik të të dhënave të gjykatës lidhur me vendimet gjyqësore dhe një kanal i komunikimit të drejtpërdrejtë online, në dispozicion në faqe zyrtare përmes së cilës qytetarët mund të ngrenë shqetësime, ankesa dhe apele. Sallat e gjykimeve janë lehtësisht të qasshme për të gjithë qytetarët përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, shumica e proceseve gjyqësore nuk janë kryer me publik, dhe as vendimet gjyqësore të publikuara së bashku me arsyetimin. Përveç kësaj, të dhënat nga seancat nuk publikohen nga gjykatat, vetëm me përjashtim të gjykatës supreme. Ndonëse publiku ka të drejtë gjithmonë i ndalohet vëzhgimi i rasteve kundër të miturve, aktgjykimet që bëhen anonime dhe ankesa ndaj tyre ende nuk publikohen në faqe zyrtare. E as nuk ka ndonjë informacion për të cilën qasja e lirë është e miratuar në pajtim me kërkesat e DQT.

Është duke u zhvilluar një plan për t'i dhënë shtetasve të drejtë për pjesëmarrje në rastin e tyre nëpërmjet internetit në mënyrë që të shohim se në cilën fazë ndodhet rasti i tyre. Megjithatë kjo qasje nuk është mundësuar ende. Ne do t'i rekomandojmë këshillave dhe gjykatave të sigurojnë informata në faqet e tyre zyrtare si linja telefonike 24 orësh të kujdesit për palë, publikime etj., në mënyrë që të jenë sa më të qasshme nga qytetarët. Një praktikë të mirë dhe e zhvilluar nga gjykatat themelore të Kosovës është prania e tyre në Facebook, që e përdorin për të bashkë vepruar më shume me publikun.

Për më tepër, nëse të gjitha institucionet, mbajnë trajnime për nëpunësit civilë lidhur me konceptin e të dhënave të hapura, si dhe lidhur me udhëzime për përdorimin dhe publikimin e të dhënave do të ndihmojë në ngritjen së tepërmi të rezultatit të indikatorëve.

Ndërgjegjësimi

Për parimin e ndërgjegjësimit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka plotësuar 82% të indikatorëve, ndërsa Gjykatat shënuan rezultat prej 48%. Mali i Zi dhe Shqipëria kryesojnë me një rezultat prej 60% të komponentit të ndërgjegjësimit të Këshillit Gjyqësor, ndërsa Gjykatat e Kosovës arrijnë të kalojnë në vendin e tretë të renditjes rajonale. Shembuj të bazuar në praktikat më të mira kosovare për ndërgjegjësim përfshijnë Gjykatën Themelore të Gjilanit, e cila plotësoi indikatorët 81%, Gjykata e Apelit, e cila kapi shifrën prej 71% ndërsa nga ana tjetër, gjykata e Ferizajt kapi shifrën vetëm 0%, pasi nuk i përgjigjet pyetësorit të dërguar për dhënien e informacionit për nivelin ndërgjegjësimi.

Megjithatë, ka pasur përparim të konsiderueshëm duke llogaritur pozicionimin nga viti i kaluar. Kryesisht për shkak të faktit se të gjitha gjykatat dhe këshilli kanë lëndë të ndara nëpërmjet një sistemi të paanshëm në mënyrë që të mbrohen kundër “blerjes së gjyqtarëve”. Për më tepër, Gjykata Themelore e Gjilanit, Gjykata Themelore në Pejë, Gjykata Supreme si dhe Gjykata e Apelit të gjitha i kanë dorëzuar raportet e tyre me kohë tek autoriteti kompetent. Gjykata e apelit dhe Këshilli Gjyqësor përfshinë gjithashtu informacione rreth masave disiplinore si dhe ankesave ndaj gjyqtarëve në raportin e tyre vjetor. Megjithatë, kjo nuk është ushtruar nga pjesa tjetër e institucioneve dhe prandaj ka ndikuar negativisht në rezultat. Këshilli gjithashtu ka raportuar probleme në raportin e punës.

Kjo është arritur në sajë të ligjit për gjykatat, i cili përcakton përmbajtjen dhe formën e raporteve të punës dërguar Këshillit Gjyqësor. Konkretisht, administratori i gjykatës, i cili punon në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit do të mbikqyrë përgatitjen e raporteve të gjykatës dhe do të sigurojë që këto janë përgatitur saktë dhe në kohën e duhur. Gjykata mund të përmirësojë performancën me anë të publikimit të statistikave mbi vëllimet e rasteve të pranuar, normat e lëndëve të zgjidhura dhe kohëzgjatjen e lëndëve të pazgjidhura si nga gjykata ashtu dhe nga gjykatësit. Për më tepër, përfshirja e masave mbrojtëse kundër vonesave të tilla si standardet e performancës ose afatet kohore normale të specifikuara për fazat e ndryshme të procedurës gjyqësore do të jetë një hap përpara drejt organizimit më të mirë të punës. Kjo praktikë ka filluar së implementuari menjëherë vetëm nga këshilli gjyqësor.

Integriteti

Me integritet, Këshilli Gjyqësor i Kosovës plotësoi 69% të indikatorëve dhe Gjykatat kanë plotësuar vetëm 15%, duke e renditur veten në pozitën e parafundit dhe duke lënë pas vetëm Serbinë, e cila ka plotësuar vetëm 15%. Nëse marrim parasysh institucionet veç e veç, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka plotësuar 69% dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës ka plotësuar 50% të indikatorëve, gjë që me këtë arrijnë rezultatin më të lartë nga institucionet në nivel të Kosovës në kuadër të kësaj kategorie. Në të kundërtën, Gjykata Themelore e Ferizajt, Gjykata Themelore e Pejës dhe Gjykata Supreme të gjitha kanë plotësuar 0% për shkak se nuk iu përgjigjën pyetësorit as nuk ofruan informacion në internet për etikën. Rezultati i këtij viti pasqyron një rënie nga matjet e vitit të kaluar dhe është kryesisht për shkak të faktit se asnjëri institucion nuk ka plan të vetin ose ndonjë tjetër, apo ndonjë politikë të instaluar kundër korrupsionit, të cilat do të parashihnin masat për parandalimin dhe eliminimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe sjelljen jo etike brenda institucionit. As nuk kanë mbajtur trajnime për zyrtarët e vet mbi tema të tilla si konflikti i interesit apo parandalimi i korrupsionit apo sinjalizimit. Ndonëse ekziston një kod i etikës për gjyqtarë, është aktualisht nën rishikim nga Këshilli Gjyqësor dhe nuk është publikuar në faqet zyrtare, me përjashtim të Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Gjykatës së Apelit. Për më tepër, vetëm Gjykata Themelore e Mitrovicës u përgjigj pozitivisht në lidhje me Kodin e Etikës dhe personelin e gjykatave, i cili është vendimtar për funksionimin e një gjyqësori të pavarur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me Kushtetutën, është një institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli gjithashtu e ka buxhetin e vet, i cili është hartuar në përputhje të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë. Për më tepër, Këshilli është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore, si dhe për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kontroll administrativ mbi Gjykatën e Supreme pasi e mbikëqyr funksionimin e gjykatave në Republikën e Kosovës dhe harton politikat dhe strategjitë për funksionimin efikas dhe efektiv të gjykatave.

Megjithatë, ekziston një mekanizëm për monitorimin dhe zbatimin e Kodeve. Në rastin e ankesave, Komisioni Disiplinor është përgjegjës për marrjen dhe administrimin e tyre. Megjithatë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka kryer ndonjë anketë për besimin e qytetarit në sistemin gjyqësor, kështu që nuk ka ndonjë pasqyrë për të fituar besimin e qytetarëve të sistemit.

Për rezultate më të mira lidhur me parimin e integritetit, ne iu rekomandojmë institucioneve t'i kryejnë trajnimet mbi etikën për gjyqtarë dhe personel të gjykatës, i cili tashmë nuk është i detyrueshëm.

Transparenca

Mbi parimin e transparencës, e cila përcakton se informacioni organizativ, buxheti dhe procedurat e prokurimeve publike janë në dispozicion të publikut dhe është i publikuar, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka shënuar një rezultat prej 45% duke e renditur Kosovën në vendin e katërt në rajon. Ndërsa gjykatat shënuan rezultat prej 61%, ku kanë zënë vendin e parë në rajon në fushën e Transparencës. Ky klasifikim në renditje, ka demonstruar përparim të rëndësishëm të vendit nga pozita e parafundit ku ishte gjatë viteve të fundit. Nëse i shqyrtojmë gjykatat veçmas, më transparentja del Gjykata Themelore e Ferizaj me shifër të arritur prej 74%. Megjithatë, shumica e institucioneve kanë plotësuar mbi 50% të indikatorëve, me përjashtim të Këshillit Gjyqësor (45%) dhe Gjykatës Themelore të Mitrovicës (49%).

Njëjtë sikur 1 vit më parë, Kosova vazhdon të ngec në publikimin e strukturës organizative për personelin e gjykatave më së shumti, në

programet dhe planet individuale të gjykatave themelore. Për më tepër, të përmendim vetëm disa nga mangësi në informacion siç janë informacionet kontaktuese apo pagat e gjyqtarëve të cilat nuk janë publikuar në faqen zyrtare. Për më tepër, KGJK-ja ende nuk ka miratuar ndonjë politikë që do të merret me qeverisjen e hapur dhe transparente, që do të rris drejtpërdrejt besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Sa i përket nën fushës së prokurimit publik ka një mungesë transparence nga çdo institucion. Buxheti vjetor për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës është hartuar nga Këshilli. Buxheti i gjykatave përfshin vetëm buxhetin vjetor të alokuar për ndërtimin, operimin dhe shpenzimet e mirëmbajtjes si dhe për alokimin e pagave. Megjithatë, nuk përfshin buxhetin e alokuar për ndihmë juridike, kompjuterizimin, investimet në ndërtesat e reja apo mbajtjen trajnimeve dhe aftësimin e gjykatësve. Për më tepër, asnjë nga vendimet, kontratat apo anekset mbi procedurat e prokurimit publik nuk janë në dispozicion në faqe interneti.

Kur është fjala për praninë/paraqitjen online të Këshillit në internet, del se e përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare. Motori i kërkimit si dhe faqja e kërkimit të ndonjë shprehje funksiononte shumë mirë. Faqja përmban gjithashtu një përshkrim të kompetencës së Këshillit dhe Gjykatës, CV e Kryetarit të institucionit dhe vendimet e këshillit gjyqësor. Megjithatë, me përjashtim të Raportit vjetor të punës, asnjë plan vjetor të punës, program dhe strategji aktuale të gjyqësorit nuk gjendet në faqen e internetit. Me qëllim të përmirësimit, ne rekomandojmë KGJK-në që të ndjekë një politikë që do të zgjidhte problemet lidhur me hapjen dhe transparencën.

Prokuroria

Prokuroria është qendër e mozaikut të institucioneve për sundimin e ligjit që sigurojnë paanshmëri, barazi dhe zbatimin korrekt të ligjit, sigurohen se nuk ka procedura në kundërshtim me ligjin, ngrisin aktakuza ndaj kriminalitetit dhe në raste të abuzimit të pushtetit. Gjendja institucioneve të prokurorisë publike ndikon rrënjësisht në gjendje e sundimit të ligjit në vend.

Ky seksion shqyrton qasshmërinë, ndërgjegjësimin, integritetin dhe transparencën e institucioneve të Prokurorisë. Pjesë e vlerësimit (të kryer

përmes pyetësorit dhe hulumtimeve të bëra nga ana e ekipit kujdestar] ish-in Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokuroria Publike, e cila përfshin Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Themelore të Gjilanit, Prokuroritë Themelore të Prishtinës, Prokurorinë Themelore të Prizrenit, Prokurorinë Speciale të Republikës Kosovës dhe Zyrës së Supreme të Prokurorit të Shtetit përkatësisht Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Mbi këto parime institucionet e Kosovës kishin kapur shifrën 48% dhe si të tilla kanë zënë vendin e tretë të klasifikimit në nivel rajoni pas Bosnje dhe Hercegovinës (49%) dhe Malit të Zi (57%).

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës renditet në nivelin mesatar të rajonit, duke mbetur relativisht e pandryshuar nga viti i kaluar. Kishte arritur rezultat me 43% të indikatorëve të plotësuar krahasuar me matjen në vitet e fundit në të cilën kishte arritur 48%, por ende gjendet në vendin e tretë të renditjes rajonale. Këshilli Prokurorial i Kosovës pasohet nga këshilli i Serbisë, i cili ka arritur të plotësojë 42% dhe Maqedonia, e cila ka plotësuar 31% të indikatorëve. Megjithatë, mbetet pas Malit të Zi, i cili kryeson me 66% dhe Bosnje e Hercegovinës me një rezultat prej 59%. Shqipëria nuk ia doli të jetë pjesë e matjes për shkak të mos funksionimit të Këshillit të Prokurorëve. Krahasuar me vitin e kaluar, të gjitha shtetet në rajon kanë pësuar rënie të madhe në plotësimin e indikatorëve ashtu që ka ngritur nivelin e alarmit sa i përket nivelit të hapjes krahasuar me këshillat prokurorial në rajon.

Qasshmëria

Në parimin e qasshmërisë, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka plotësuar vetëm 11% ku ka dalë barazi me Maqedoninë, dhe që të dy vendet janë renditur si të fundit në nivel të rajonit. Këshilli publikon të gjitha vendimet në faqe në internet, ku ato janë gjithashtu të kategorizuara sipas vitit. Megjithatë, nuk ka pasur person kontaktues i cili do të ishte në dispozicion në faqen zyrtare të internetit që do jetë përgjegjës për qasje në informata të rëndësishme, për ndonjë informacion për të cilën qasja e lirë është miratuar në pajtim me kërkesat e DQT. As nuk ka kanal direkt në dispozicion për komunikim të të dhënave të gjykatës me rastin e nxjerrjes së vendimeve gjyqësore përmes së cilit qytetarët mund të paraqesin shqetësime, ankesa dhe apele. KPK ka dalë me rezultat më ulët falë dështimit për të

realizuar dhe vënë në dispozicion arsyet e mësipërme, për më tepër, dështimi për të krijuar një mekanizmin ankesash lidhur me punën e prokurorisë publike, dhe për mungesë të ofrimit të udhëzimeve që rregullojnë raportimin e mediave dhe që i mundësojnë prokurorisë punonjësve të vlerësojnë informatat dhe të ndërmarrin detyrimet e tyre sipas ligjit mbi DQT. Prandaj, rekomandohet që të fillohet me Këshillin Prokurorial organizimin e trajnimeve vjetore për shërbyesit civil për konceptin e open data, udhëzime për përdorimin dhe publikimin e të dhënave si dhe në fushën e qasshmërisë në informacionin publik. Përveç kësaj zbatimi i direktivave ose strategjive për bashkëpunim me media dhe raportimin e tyre për punën e Këshillit Prokurorial do të ndihmonte drejt përmbushjes së indikatorëve dhe e bën Këshillin më të qashtëm për qytetarët. Megjithatë, a janë të njohur me miratimin e Strategjisë për Komunikim 2018-2020.

Ndërgjegjësimi

Lidhur me ndërgjegjësimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës rezultati ka kapur shifrën prej 46%, që e vendos në pozitën e parafundit dhe duke e lënë pas vetëm Serbinë e cila kishte arritur rezultat prej 17%. Nga ana tjetër Bosnja dhe Hercegovina kryeson renditjen rajonale me rezultatin e ideal prej 100%. Ndonëse nuk ka asnjë ndryshim në renditjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ai ka pësuar një rënie prej 4% të rezultatit në krahasim me vitet e fundit.

Ngjashëm me rezultatet e vitit të kaluar akoma vazhdon të ketë mungesë së rregulloreve që përcaktojnë përmbajtjen dhe formën e punës të paraqitur pranë Këshillit Prokurorial. Përveç kësaj, zyra e prokurorisë nuk ka raportuar rreth problemeve që janë pjesë e raportit të punës.

Megjithatë, ekziston një detyrim për Këshillin Prokurorial të paraqesë një raport mbi punën e tij. Obligimet dhe afatet kohore për raportimin janë të përcaktuara me ligj, i cili parashikon se raporti vjetor përfshin masat disiplinore dhe ankesat në drejtim të prokurorëve. Megjithatë raporti vjetor për vitin 2018, ende nuk është publikuar e as për vitet e kaluara, vetëm ai i vitit 2017.

Integriteti

Kosova ka arritur plotësimin e 58% të indikatorëve mbi parimin e integritetit, duke e renditur veten në pozitën e tretë në renditjen e rajonit pas Malit të Zi (91%) dhe Bosnje dhe Hercegovinës (71%). Siç parashihet me Kushtetutë, Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial është përgjegjës për rekrutimin, propozimin, promovimin, bartjen, riemërimin dhe disiplinimin e prokurorëve, në rast të ankesave, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Sipas Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshilli do të menaxhojnë buxhetin vjetor për veten dhe për zyrat e prokurorisë në mënyrë të pavarur, dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve, dhënien e fondeve, mirëmbajtjen e llogarive të sakta dhe aktuale dhe auditime financiare.

Për më tepër, ka një kod etik për prokurorët dhe stafin i cili është në dispozicion në faqen e internetit të Këshillit. Sipas këtij kodi të etikës trajnimi për prokurorë është i detyrueshëm pasi që nga ana e prokurorëve pritet që tu përmbahen dhe të përmirësojnë standardet më të larta të profesionalizmit dhe ekspertizës ligjore, dhe për këtë qëllim, angazhohen në edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm ligjor kurdo që është e mundur, ky kod nuk arrin të rregullojë plotësisht çështjet mbi konfliktin e interesit, shfrytëzimin e pronës shtetërore, dhuratat dhe favoret.

Këshilli Prokurorial nuk ia del të mbajë trajnime apo aktivitete të tjera të aftësimi profesional për zyrtarët e vet mbi tema të tilla si konfliktin e interesit, parandalimin e korrupsionit apo sinjalizimin. Praktika të tilla si anketimi i qytetarëve në lidhje me besimin në zyrën e prokurorit do të rriste rezultatin në këtë parim. Për të shënuar më shumë progres në këtë fushë ne gjithashtu rekomandojmë që të zbatohet një plan i integritetit ose ndonjë politikë tjetër e brendshme kundër korrupsionit, e cila do të përmbante masa parandaluese dhe do zhdukte forma të ndryshme korruptive dhe sjellje jo etike brenda institucionit.

Transparenca

Sa i përket transparencës, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përmbushur 49% të indikatorëve. Pasi që Mali i Zi arriti gjithashtu të njëjtën përqindje, të dy vendet janë renditur në dy pozitat kah fundi, duke e lënë pas vetëm Maqedoninë (30%). Prijëse është Serbia, e cila shënoi rezultat prej 64%. Kjo e bën që Këshilli i Serbisë të jetë më transparent brenda rajonit, pasuar nga Këshilli i Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili shënoi rezultat prej 52%.

Lidhur me transparencën e informacionit organizativ, Këshilli Prokurorial i Kosovës shënoi rezultat prej 87% ku ka dështuar vetëm në publikimin e informatave për pagat e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, por jep informacion për personelin, siç janë emrat, pozitat dhe informacionin kontaktues të stafit të Këshillit Prokurorial. Megjithatë, Këshilli Prokurorial është konsistent në azhurnimin e faqes zyrtare. Faqja përmban gjithashtu një organogram, një përshkrim të kompetencës së Këshillit Gjyqësor, dhe CV-në e Kryetarit të institucionit dhe vendimet e këshillit gjyqësor. Programet vjetore të punës, planet dhe raportet publikohen në faqen e internetit si dhe në strategjitë konkrete. Informacioni për anëtarët e Këshillit Prokurorial, si emrat me kontakte si dhe informacione lidhur me procesin e përzgjedhjes së prokurorëve dhe përzgjedhjen e kriterëve është gjithashtu në dispozicion. Rëndësi të madhe ka fakti se ky Këshill ka zbatuar një rregullore që merret me nivelin e hapjes dhe transparencës.

Akoma, kur është fjala për fusha/nën-fusha të tjera, ekziston një mungesë e dukshme e përpjekjeve për të mbajtur transparencën. Në nën-fushën e prokurimit publik, Këshilli Prokurorial kap shifrën 0%, duke qenë se asnjë prej planeve, telefonatave, vendimeve, kontratave apo anekseve mbi procedurat e prokurimit publik nuk është në dispozicion në faqen zyrtare. Rezultat i ngjashëm i pakënaqshëm është arritur edhe në nën-fushat e transparencës buxhetore. Këshilli Prokurorial dështon përsëri të publikojnë planet buxhetore ose të shpenzimeve buxhetore, në faqen zyrtare. Buxheti i Prokurorisë as nuk përmban buxhet vjetor të alokuar për infrastrukturë teknike të tilla si, pajisjet e TI-së dhe mirëmbajtjen e tyre, as operimin dhe mirëmbajtjen e objektit apo kostove. Për më tepër, buxheti nuk arrin të përfshijë buxhetin vjetor të alokuar për trajnimin dhe aftësimin e prokurorëve.

Prokuroria Publike

Kjo është nga fakti se prokuroritë publike përballen me sfida serioze në punën e tyre në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kur vjen puna për një prokurori publike të hapur të Kosovës ajo mbërrin vendin e dytë në renditjen e rajonit. Me një rezultat prej 50% ku Mali i Zi ia kalon me (54%). Në vlerësim ishin të përfshira Prokuroria e Apelit, Prokuroria Themelore e Gjilanit, Prokuroria Themelore e Prishtinës, Prokuroria Themelore e Prizrenit dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Qasshmëria

Qasshmëria është e lidhur me ofrimin dhe respektimin e procedurave për qasje të lirë në informata, përmirësimin informatave në dispozicion përmes një mekanizmi të një debati publik, forcimin dhe bashkëveprimin me qytetarë. Mbi këtë parim Prokuroria Publike e Kosovës plotësoi 39% dhe u rendit e treta nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ku renditet pas Malit të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinës.

Në Kosovë, Prokuroria Themelore e Gjilanit është vlerësuar si më e qasshme, me 64%. Ajo pasohet nga Prokuroria e Speciale, e cila arrin 52%. Në anën tjetër, institucioni më pak i qasshëm është Prokuroria Themelore e Prishtinës me 14%, e cila dështoi për t'iu përgjigjur pyetësorit lidhur me informatat e kërkuara sipas ligjit për DQT.

Të gjitha institucionet kanë kontaktet e personit përgjegjës për qasje në informacion me rëndësi publike që mund t'i gjeni në faqen zyrtare. Me përjashtim të Prokurorisë Speciale asnjë nga institucionet nuk ka organizuar trajnime për stafin e tyre në fushën e qasjes në informacionin publik ose në konceptin e të dhënave të hapura dhe udhëzimet për përdorim dhe publikim të të dhënave. As nuk ka udhëzime për bashkëpunim me medie për raportimin mbi punën e prokurorisë. Përjashtim këtu bëjnë Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Themelore e Prishtinës.

Ndërgjegjësimi

Mbi parimin e ndërgjegjësimit, Prokuroria Publike arrin 71%, pra del e dyta pas liderit Mali i Zi me (72%). Duke pasur parasysh institucionet veç e veç, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Themelore e Prizrenit dhe Prokuroria Themelore e Gjilanit të gjitha kanë shënuar rezultate optimale prej 100%. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës 55% dhe Prokuroria Themelore e Prishtinës arrin 0% për të gjithë indikatorët, pasi nuk përgjigjet në pyetësor. Ky rezultat është më i kënaqshëm për shkak të zbatimit të një mekanizmi për ndarjen e lëndëve. Përveç kësaj, zyra e prokurorisë ka dërguar një raport mbi punën e saj për vitin e kaluar për autoritetin kompetent brenda një afati ligjor me përjashtim të Prokurorisë Speciale.

Raporti i punës përfshin indikatorët e performancës së veprimtarisë së prokurorisë siç është numri i rasteve të zgjidhura, numri i aktgjykimeve të arritura. Raporti vjetor, me përjashtim të Prokurorisë Speciale, përfshin gjithashtu informacion rreth ankesave ndaj prokurorëve dhe masat disiplinore.

Integriteti

Rezultati i përgjithshëm lidhur me parimin e integritetit është 42%. Për këtë arsye Prokuroria Publike vjen e treta si e renditur në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Lidhur me institucionet brenda kësaj strukture Prokuroria e Apelit renditet si më e larta, përkatësisht me 62%, ndërsa Prokuroria Themelore e Gjilanit, Prishtinës, Prizrenit dhe Prokuroria Speciale e Republikës Kosovës të gjitha kanë kapur shifrën prej 37%. Ka një kod i etikës për prokurorë, që është publikuar edhe në faqen e internetit të Prokurorit të Shtetit. Edhe pse, me përjashtim të Gjykatës së Apelit, të tjerat nuk një plan të integritetit ose ndonjë politikë tjetër të brendshme kundër korrupsionit, e cila do të përmbante masa parandaluese dhe do zhdukte forma të ndryshme korruptive dhe sjellje jo etike brenda institucionit. Për më tepër, asnjë nga institucionet në kuadër të Prokurorisë publike nuk ka organizuar trajnime për zyrtarët e vet mbi tema të tilla si konflikti i interesit, parandalimi i korrupsionit dhe sinjalizimin.

Transparenca

Parimi i transparencës parasheh që informacioni organizativ dhe procedura e buxhetit për prokurime publike të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikohen. Këtu Prokuroria Publike e Kosovës është lider në rajon me një rezultat prej 53%. Nëse i shikojmë ndaras, të gjitha institucionet në kuadër të strukturës kanë përmbushur rreth 50% të indikatorëve. Prokuroria Themelore e Gjilanit arriti rezultatin më të lartë prej 56% duke e bërë institucionin më transparent. Nga ana tjetër, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka performancën më të ulët, me 49%.

Faqja zyrtare e internetit në dispozicion përmbush kërkesën ligjore për publikimin e të gjitha të dhënave të nevojshme në një faqe zyrtare. Ajo përmban përshkrimin e kompetencës së prokurorit publik dhe CV-në e Kryetarit të institucionit, si dhe programe vjetore të punës, plane dhe strategji aktuale. Po ashtu, edhe vet publikon raportin vjetor dhe raportet e fundit të punës tremujore./gjashtë mujore. Kosova karakterizohet me konsistencë në përditësimin e rregullt faqeve zyrtare. Megjithatë, ka një sprapsje që ka të bëjë me makinën e kërkimit që nuk punon në mënyrën më të mirë. Përveç kësaj, nuk ka qasje në tabelën e shpalljeve online në faqen e parë. Për më tepër, vetëm Prokuroria Themelore e Gjilanit dhe Prokuroria Themelore e Prizrenit publikojnë informacionet për prokurorë si dhe informatat për personelin si emrat, pozitat dhe kontaktet e stafit të prokurorisë publike në faqen e tyre të internetit. Së fundi, institucionet në kuadër të Prokurorisë Publike nuk kanë asnjë dokument në vend që merret me hapjen dhe transparencën e tyre. Por tani me faqet e përditësuara së fundmi, këto informata pas matjeve po dalin se po mungojnë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në Kosovë arrin në përgjithësi 44% të plotësimit të indikatorëve dhe kështu radhitet veten si e treta. Kjo është një rritje e madhe e nivelit të hapjes së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, pasi që në matjen e fundit u rendit e fundit në rajon ku kishte arritur me 30% të plotësimit të indikatorëve. Shtetet që prijnë për nga niveli i hapjes ndërmjet Zyrave të Kryeprokurorit të Shtetit janë Shqipëria, e cila kap shifrën prej 68% dhe Mali i Zi, ka kapur shifrën prej 63%.

Në këtë renditje Kosova ka lënë mbrapa Serbinë (30%) dhe Maqedoninë (22%). Ndërsa, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, është instanca më e lartë e shtetit, dhe me shtrirje të autoritetit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës duhet të jetë shembull për prokuroritë e tjera publike.

Qasshmëria

Lidhur me Serbinë, e cila renditet si e parafundit (e ka tejkaluar vetëm Maqedoninë), Kosova shënon rezultat prej 36% në qasshmëri. Pikët më të madha i ka arritur Mali i Zi (80%), i ndjekur nga Shqipëria (73%). Kosova arrin këtë rezultat nëpërmjet disa praktikave: nuk ka emër të personit përgjegjës për qasje në informata me rëndësi publike që duhet të jenë në dispozicion në faqen zyrtare, megjithatë një kontakt të përgjithshëm e ka ofruar. Një praktikë të mirë e ka treguar Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit duke ofruar udhëzime për bashkëpunim me media dhe komunikim me publikun në lidhje me raportimin mbi punën e prokurorisë. Megjithatë, ky institucion ka dështuar të mbajë trajnim në fushën e qasjes në informacionin publik ose në konceptin e open data apo të dhënave të hapura dhe udhëzimet për përdorimin dhe publikimin e të dhënave, në mënyrë që të jetë në gjendje për të përmirësuar informimin dhe komunikimin me qytetarët. Si institucion i tillë, qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për llojin e informatave që duhet t'u vihen në dispozicion për shkak se institucionet, dështojnë të publikojnë listat e regjistrave të dokumenteve që posedojnë. Përveç kësaj, nuk ka udhëzime për ngritje të shqetësimeve, apo për të parashtruar ankesa apo apele dhe për t'i publikuar të njëjtat në faqen zyrtare. Përveç udhëzimeve, ZKPSH-ja nuk ka kanal të komunikimit online të drejtpërdrejtë në dispozicion në faqen e internetit përmes së cilës qytetarët mund të parashtrojnë shqetësime, ankesa dhe apele.

Megjithatë, një ngecje vërehet te makina e kërkimit që nuk punon në mënyrën më të mirë. Përveç kësaj, nuk ka qasje në tabelën e shpalljeve online në faqen e parë.

Ndërgjegjësimi

Kosova renditet ndër vendet më të larta në aspektin e ndërgjegjësimit duke shënuar 76% e që del baras me Malin e Zi dhe Shqipërinë.

Ndërkohë Maqedonia dhe Serbia kanë dështuar të përmbushin çfarëdo kërkesë dhe prandaj kanë arritur 0% të indikatorëve, zyra e kryeprokurorit të shtetit dërgoi një raport mbi punën e saj për vitin e kaluar për autoritetin kompetent brenda afatit ligjor. Këto raporte të punës përfshijnë indikatorët e performancës së veprimtarisë së prokurorisë siç është numri i rasteve të zgjidhura, numri i aktgjykimeve të fituara e të tjera. Megjithatë, raporti vjetor nuk përmban informacion për masat disiplinore, ankesave ndaj prokurorëve. Çdo vit, Këshilli Prokurorial mbikëqyr punën e Prokurorive Themelore.

Integriteti

Shqipëria dhe Mali i Zi kanë përmbushur 100% të kërkesave, të pasuara nga Kosova e cila plotësoi 50% të indikatorëve duke u renditur e treta në rajon. Kosova ka bërë progres të dukshëm, duke marrë parasysh rezultatin e vitit të kaluar prej 10% ku renditej e fundit në rajon. Ka një kod të etikës për prokurorë dhe staf, i cili është publikuar në faqen e internetit dhe ekziston një mekanizëm për ndarjen e lëndëve të implementueshme.

Megjithatë, nuk ka plan të publikuar të integritetit ose ndonjë politikë tjetër të brendshme kundër korrupsionit, (e cila do të përmbante masa parandaluese dhe do zhdukte forma të ndryshme korruptive dhe sjellje jo etike brenda institucionit). Për më tepër, nuk ekzistojnë trajnime/seminare apo aktivitete të tjera aftësimi për zyrtarët e saj mbi tema të tilla si për konfliktin e interesit/parandalimin e korrupsionit/ sinjalizimin në rast të parregullsive. Këto kufizime pengojnë progresin e Kosovës drejt arritjes së integritetit të lartë.

Transparenca

Kosova është renditur e treta në nivel rajonal, me një rezultat prej 40% kur është fjala për transparencën. Është tejkaluar nga Shqipëria (58%) dhe Mali i Zi (44%), por ka dalë përpara shteteve të Serbisë (39%) dhe Maqedonisë (34%).

Zyra e Kosovës në faqen e Kryeprokurorit të Shtetit përmbush kërkesën ligjore për publikimin e të gjitha të dhënave dhe informatave të nevojshme në faqen zyrtare. Ajo përmban përshkrim të kompetencës së kryeprokurorit publik të shtetit dhe CV-në e Kryetarit të institucionit, si dhe programe vjetore të punës, plane dhe strategji aktuale.

Po ashtu, edhe vet publikon raportin vjetor dhe raportet e fundit të punës tremujore./gjashtë mujore. Kosova karakterizohet me konsistencë në përditësimin e rregullt faqeve zyrtare.

Për më tepër, informacioni mbi prokurorët si dhe informatat për personelin si emrat, pozitat dhe kontaktet e stafit të prokurorit publik janë të disponueshme në faqen e internetit, por jo gjithëpërfshirëse e as shteruese. Së fundi, informacioni mbi pagat e prokurorëve nuk është publikuar në faqen e internetit.

Një pengesë e madhe e Kosovës drejt forcimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit është se nuk ka politika që merren me nivelin e hapjes dhe transparencës. Sa i përket nën-fushës së prokurimit publik dhe transparencës së buxhetit, Prokuroria e Shtetit ka arritur rezultat 0%. Kjo është për shkak të faktit se nuk kishte plane, thirrje, vendime, kontrata e as ndonjë aneks mbi procedurat e prokurimit publik të vëna në dispozicion në faqen e internetit, dhe e njëjta vlen edhe për planet e buxheteve ose raportet për shpenzimet e buxhetit.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Qeverisja e hapur është një kërkesë kyçe e demokracisë, sepse u mundëson qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, efikase dhe mbajtjen e institucioneve si përgjegjëse për politikën që zbatojnë. Institucionet në mbarë botën janë duke ndërmarrë veprime konkrete në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve. Me qëllim të përcaktimit të shkallës në të cilën qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin informacionin e duhur dhe të kuptueshëm nga institucionet e tyre, është zhvilluar një Indeks Rajonal i Nivelit të Hapjes. Indeksi Rajonal i Nivelit të Hapjes mat shkallën në të cilën institucionet e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, bazuar në katër parime: (1) Transparenca (2) Qasshmëria (3) Integriteti dhe (4) Ndërgjegjësimi

Parimi i transparencës nënkupton që informacioni organizativ dhe procedura e buxhetit për prokurime publike të jenë në dispozicion të publikut dhe të publikohen.

Qasshmëria i referohet faktit kur parashihet respektimi i procedurave për qasje të lirë në informata dhe forcimit të qasjes në informacion nëpërmjet mekanizmit të dëgjimeve publike dhe forcimit të bashkëveprimit me qytetarë. Integriteti përfshin mekanizmat për parandalimin e korrupsionit, zbatimin e Kodeve të Etikës dhe rregullimin e lobimit. Parimi i fundit, ndërgjegjësimi, ka të bëjë me monitorimin dhe vlerësimin e politikave të zbatuara nga institucionet. Sipas standardeve ndërkombëtare, rekomandimet dhe shembujt e praktikës së mirë, këto parime elaborohen përmes indikatorëve të veçantë sasiorë dhe cilësorë që vlerësohen mbi bazën e pasjes së informacionit në faqet zyrtare të institucioneve, cilësinë e kuadrit ligjor për çështje individuale, burime të tjera të informimit publik dhe pyetësorët që i përcillen institucioneve.

Ndërmjet 30 dhe 65 indikatorëve për një institucion, ne kemi matur dhe analizuar qeverisjen e hapur në të gjitha organet gjyqësore në rajon dhe të dhënat e mbledhura arrijnë shifrën prej 8000 të dhënash. Pas mbledhjes së të dhënave u bë procesi i verifikimit të tyre, që rezultoi në standardin gabimit prej +/-3%. Matja u krye në periudhën nga dhjetori 2018 deri në fund të shkurtit 2019. Një sërë rekomandime dhe udhëzime të orientuara drejt institucioneve janë zhvilluar mbi bazën e rezultateve të kërkimit.

Rreth ActionSEE

ACTION SEE (Accountability, Technology and Institutional Openness Network in the South East Europe region) është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë së bashku në promovimin e llogaridhënjes në regionin e Evropës Jug-Lindore, duke ngritur potencialin për aktivizëm qytetar, promovimin e të drejtave të njeriut dhe liritë në internet, dhe duke ndërtuar kapacitetet dhe interesimin brenda shoqërisë civile për të përdorur teknologjinë për promovimin e demokracisë.

Antarët themelor të organizatës janë Metamorphosis nga Maqedonia, Center for Democratic Transition nga Mali i Zi, Center for Research, Transparency and Accountability nga Serbia, dhe Why Not nga Bosnja dhe Herzegovina. ACTIONSEE punon me partnerët nga Shqipëria të organizatës MJAFT! dhe Open Data Kosovo nga Kosova.

Open Data Kosovo (ODK) beson se hapja e të dhënave publike është shumë e rëndësishme në ndërtimin e një qeverisjeje të mirë, transparente dhe llogaridhënëse. Prandaj, të dhënat e zotuar nga institucionet shtetërore duhet të jenë publike, lehtë të qasshme dhe të prezentohen në formate të hapura. Publikimi i të dhënave të institucioneve shtetërore përmban kushtin bazik që qytetarët, shoqëria civile, akademitë dhe palët tjera të interesuara t'i përdorin këto të dhëna për të ndikuar pozitivisht në shoqëri.

OPEN DATA KOSOVO

Adresa: Rruga "Ganimete Terbeshi" 26A,
10000 Prishtina, Kosove

Email: info@opendatakosovo.org

Website: www.opendatakosovo.org



This project is funded by
the European Union

METAMORPHOSIS 



CRTA

CENTER FOR RESEARCH
TRANSPARENCY AND
ACCOUNTABILITY

ZaštoNe? 



The "Accountability, Technology and Institutional Openness Network in South East Europe - ACTION SEE" project is implemented by Metamorphosis Foundation, Westminster Foundation for Democracy, CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability, Citizens Association Why not?, Center for Democratic Transition, Open Data Kosovo (ODK) and Levizja Mjajt!.